GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë

BOTIMI I DHJETË

Nëntor 2026



ROLPIK Rule of Law Performance Index in Kosovo

rolpik.org

Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë, Edicioni i Dhjetë

Nëntor 2026

©Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë, Nëntor 2026

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, stafit, bashkëpunëtorëve ose përfaqësuesve të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij edicioni nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo nga çfarëdo mjeti pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike për kërkesat e tilla.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike
Rr. "Rexhep Luci" 16/1
Prishtinë 10 000, Kosovë
www.legalpoliticalstudies.org
office@legalpoliticalstudies.org
+383 38 234 456

Autor:
Liridon Salihi

Kontribuese:
Elona Kurti

*Grupi për Studime Juridike dhe Politike

RoLPIK – Edicioni i Dhjetë është produkt i Grupit për Studime Juridike dhe Politike që përkrahet nga programi i KCSF 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, apo Suedisë.

RRETH ROLPIK

Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë (Rule of Law Performance Index in Kosovo – RoLPIK) është produkt i Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) që për vite me radhë vlerëson perceptimin qytetarë për punën e institucioneve të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Përveç të dhënave nga anketa me qytetarë, RoLPIK ofron edhe të dhëna statistikore mbi efikasitetin e gjyqësorit në zgjidhjen e lëndëve dhe ndarjet buxhetore për sistemin e drejtësisë nga viti 2013 e tutje.

Si mekanizëm monitorimi, në edicionin jubilar të 10-të të RoLPIK-ut analizohet dhe pasqyrohet perceptimi qytetar në raport me institucionet e sundimit të ligjit, me theks të veçantë në punën e gjykatave dhe prokurorive, duke ofruar edhe të dhëna të detajuara nga raportet vjetore të punës së gjyqësorit si ngarkesa me lëndë, numri i lëndëve të zgjidhura, buxheti institucional etj.

Të gjitha edicionet e RoLPIK janë të qasshme në ueb faqen: https://www.rolpik.org/

HYRJE

Gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës dhe Institucioni i Prokurorit të Shtetit vazhdojnë të jenë subjekt i kritikave të publikut të gjerë. Raporte të ndryshme ndërkombëtare por edhe ato vendore vënë theksin sidomos në politikën e ultë ndëshkimore, amnistimim e personave të profilit të lartë dhe atyre të lidhur me politikën, mos respektimin e parimit për gjykim të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme, dështimin e aktakuzave për shkak të mangësive në fazën e ngritjes së tyre, e nivel i ultë i konfiskimit të pasurisë së fituar përmes aktiviteteve kriminale.[1] Po ashtu, llogaridhënia dhe transparenca mbesin dy komponentë të rëndësishëm të cilat kërkojnë fokus dhe veprime konkrete institucionale nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), si trupa që menaxhojnë me sistemin gjyqësor në vend.

Megjithatë organet menaxhuese, KGJK dhe KPK nuk mund të mbahen përgjegjës për të gjitha ngecjet që aktualisht ka gjyqësori në Kosovës. Një pjesë e përgjegjësisë i mbetet pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, që përmes deklaratave publike dhe mostrajtimit me seriozitet të kërkesave buxhetore vazhdojnë të cenojnë parimin e ndarjes së pushteteve dhe pavarësinë funksionale të këtyre organeve por edhe të vetë gjykatave dhe prokurorive.

Gjatë vitit 2025 dhe pjesës së parë të vitit 2026, Kosova u përball me një krizë të vazhdueshme institucionale, ku pjesa më e madhe u karakterizua nga mungesa e një Kuvendi të konstituuar dhe funksionimi i Qeverisë me mandat në detyrë. Kjo situatë ndikoi edhe në mosjetësimin e disa reformave të rëndësishme në fushën e

1 Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Trajtimi institucional i rasteve të korrupsionit: Sfidat e sistemit gjyqësor gjatë një viti, Maj 2024, link: https://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2024/06/GLPS-Act-Now-Raporit-Vjetor-Trajtimi-Institucional-i-Rasteve-te-Korrupsionit-te-Profilit-te-Larte-ne-Kosove_compressed.pdf dhe Komisioni Evropian (KE), Raporti për Kosovën 2025, Nëntor 2025, link: https://enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2025_en

drejtësisë, përfshirë procesin e Vettingut, themelimin e Byrosë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, si dhe avancimin e projektligjeve që burojnë nga Deklarata e Përbashkët e Zotimit. Sa i përket Projektligjit për Byronë dhe pesë projektligjeve të Deklaratës, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e datës 26 shtator 2026 votoi miratimin e tyre dhe të njëjtat u dërguan për procedim tutje në Kuvend. Në seancën e Kuvendit të mbajtur më 5 tetor 2026, këto gjashtë projektligje u votuan në lexim të parë.[2] Projektligjet në kuadër të Deklaratës janë pjesë e Agjendës së Reformave të Planit të Rritjes dhe synimi i këtyre nismave ligjore është forcimi i sundimit të ligjit si dhe për të rritur rezultatet e institucioneve dhe besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, Kosova vazhdon të mos ketë një Strategji Kombëtare Kundër Korrupsionit. Ndonëse Qeveria kishte një mandat të plotë 4 vjeçar dhe më pas vazhdoi të funksionojë si qeveri në detyrë për rreth dy vite, ajo nuk arriti të hartojë dhe miratojë Strategjinë Kombëtare Kundër Korrupsionit. Një dokument i tillë do të duhej të përcaktonte objektiva të qarta, masa konkrete, afate kohore dhe përgjegjësi institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Por, mungesa e një dokumenti të tillë nuk mund t'i atribuohet vetëm faktit se një periudhë kohore vendi ynë nuk kishte Qeveri me mandat të plotë, por mungesa e vullnetit institucional ka bërë që Kosova një dokument të tillë strategjik e ka zbatuar në periudhën 2013-2017, kurse Strategjitë pasuese 2019 – 2023 dhe 2021 – 2023 nuk ishin implementuar për shkak të krizave politike. ..[3] Pra, kanë kaluar mbi 8 vite kur vendi ynë nuk arrin të hartojë dhe të zbatojë një strategji institucionale për t'iu qasur një nga problematikave kryesore në sundimin e ligjit dhe në perceptimin publik.

Korrupsioni vazhdon të përbëjë një sfidë për institucionet publike në Kosovë. Përkundër deklarimeve publike të vazhdueshme të akterëve politikë për përkushtimin ndaj luftimit të korrupsionit, mungesa e një dokumenti strategjik kombëtar tregon për dobësi në planifikimin dhe koordinimin institucional të politikave kundër korrupsionit. Për këtë arsye, miratimi i një strategjie të tillë nuk duhet të trajtohet vetëm si përmbushje formale e një obligimi institucional, por si një instrument për përcaktimin e prioriteteve, masave dhe përgjegjësive konkrete në adresimin e korrupsionit.

Prandaj, për të vlerësuar se si shihen të gjitha këto zhvillime në sytë e qytetarëve, dhe cili është perceptimi i tyre në raport me efikasitetin institucional në luftimin e kriminalitetit, ndikimin e politikës në gjyqësor, sa i besojnë Dhomave të Specializuara në Hagë dhe të tjera, GLPS përmes UBO Consulting gjatë muajit korrik 2026, ka realizuar një anketë me 1492 qytetarë të moshës mbi 18 vjeçare, të gjinive, komuniteteve dhe komunave të ndryshme në Republikën e Kosovës.

Gjetjet kryesore nga anketa me qytetarët janë si më poshtë:

- 58.2% e të anketuarve konsiderojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji;
- 35.5% e të anketuarve kanë deklaruar se Gjykatat kanë prirje të ndikohen nga politika, 31.3% ndikimin politik e shohin tek Prokuroria, ndërsa 15.7% te Policia dhe 10.2% tek Oda e Avokatëve të Kosovës;
- 25% e të anketuarve mendojnë që zyrtarët e institucioneve të drejtësisë kërkojnë apo pranojnë ryshfet, duke

2 Ministria e Drejtësisë, Pakoja e projektligjeve të reformës në Drejtësi miratohet në lexim të parë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, 5 tetor 2026, e qasshme në linkun: https://md.rks-gov.net/lajmet/pakoja-e-projektligjeve-te-reformes-ne-drejtesi-miratohet-ne-lexim-te-pare-nga-kuvendi-i-republikes-se-kosoves/

3 Kallxo.com, Pse Kosova nuk ka strategji kundër korrupsionit?, Tetor 2026, link: https://www.youtube.com/watch?v=sbzuaMwFkzk dhe Qeveria e Kosovës, Strategjia Kundër Korrupsionit, Nëntor 2020, link: https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/Strategjia-Kunder-Korrupsionit-2021-2023-1.pdf, dhe Startegjia kundër korrupsionit 2019 – 2023, Mars 2019, link: https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/08/Strategjia-Kunder-Korrupsionit-2019-2023-1.docx

renditur zyrtarët e gjykatave me 40.6%, të prokurorive me 34.9% dhe të Policisë me 20.1% si persona më të ndikuar nga ky fenomen;

- Policia mbetet institucioni më i besueshëm për qytetarët që të raportojnë raste të krimit dhe vazhdon të vlerësohet si institucioni që është me efektiv në luftimin e kriminalitetit, pasuar nga organizatat e shoqërisë civile, mediat;
- Rreth 70% e të anketuarve janë deklaruar se janë të gatshëm të raportojnë raste të krimit;
- Vetëm 4.8% e të anketuarve janë deklaruar se janë palë në procese gjyqësore që zhvillohen pranë gjykatave të Republikës së Kosovës, shumica e tyre në cilësinë e paditësit (45.3%) dhe të dëmtuarit (40.6%);
- Vetëm 23.3% deklarojnë se kanë pranuar shërbime në 5 vitet e fundit nga institucionet e drejtësisë;
- Në shkallën e vlerësimit 1 deri në 5, me mesataren 3.5 qytetarët e vlerësojnë mekanizmin për përcjelljen e statusit të lëndëve në Gjykatë dhe pajisjen me Certifikatën mbi Dënimet Penale - në mënyrë digjitale;
- Në shkallën e vlerësimit 1 deri në 5, me mesataren 3 është vlerësuar se institucionet e drejtësisë i trajtojnë në mënyrë të barabartë personat/grupet e margjinalizuara;
- Policia vazhdon të vlerësohet si institucioni më i pavarur në ushtrimin e kompetencave të saj, pasuar nga gjykata dhe prokuroria;
- Rreth 55% e të anketuarve kanë deklaruar se gjyqtarët marrin vendime nga ndikimet e jashtme si korrupsioni apo presioni politik;
- Rreth 48% e të anketuarve nuk shohin përmirësim në sistemin e drejtësisë gjatë 5 viteve të fundit. Ndërsa 36% e të anketuarve që kanë vlerësuar se gjyqësori është përmirësuar në këtë periudhë kohore, përmirësimin më të madh e shohin tek llogaridhënia dhe transparenca;
- Më shumë se gjysma e të anketuarve kanë vlerësuar se mungesa e konsensusit dhe e vullnetit politik janë pengesat kryesore për mosrealizimin e reformave në drejtësi (Vettingu dhe Byroja);
- Për rritjen e efikasitetit të gjyqësorit, të anketuarit i japin përparësi mbështetjes dhe ruajtjes së pavarësisë së institucioneve aktuale në raport me krijimin e institucioneve të reja të specializuara;
- Në mes vlerave 1 – aspak e sigurtë dhe 5 – plotësisht e sigurtë, me mesataren prej 3.4 është vlerësuar niveli i sigurisë në vend nga ana e të anketuarve;
- Në shkallë vlerësimi nga 1 deri në 5, me 2.5 është vlerësuar besimi i qytetarëve ndaj Dhomave të Specializuara të Kosovës për vendime të drejta dhe të pavarura;
- Me vlerën 3.1 nga një shkallë vlerësimi prej 1 deri në 5, të anketuarit i kanë vlerësuar si meritore dënimet që u shqiptohen të akuzuarve për dhunë në familje/dhunë me bazë gjinore.

METODOLOGJIA

RoLPIK – Edicioni i Dhjetë, ashtu si në edicionet paraprake përbëhet nga dy pjesë, pjesa e parë analizon të dhënat nga anketa me qytetarët, kurse në pjesën e dytë trajtohen të dhënat nga raportet e punës së gjykatave dhe prokurorive për vitin 2025.

Sa i përket indikatorit të perceptimit qytetarë, të dhënat përfshijnë anketën që është reprezentative për vendin dhe në të kanë marrë pjesë 1492 qytetarë të gjinive, grupmoshave, nivelit të shkollimit, punësimit dhe të ardhurave ekonomike të ndryshme. Anketa ka përfshirë 20 pyetje dhe 4 nënpyetje me opsione të përgjigjeve të shumëfishta dhe rotative. Gjysma e të anketuarve kanë qenë burra dhe gjysma tjetër gra, kurse sa i përket etnisë 88% janë shqiptarë, 7% serb, kurse 5% të tjerë të anketuar janë deklaruar si boshnjak, ashkali, turq, goran, romë, dhe egjiptian. Rreth 59% e të anketuarve kanë qenë banorë në zonat rurale kurse 41% të tjerë në zona urbane.

Në indikatorët strukturorë, janë analizuar të dhënat nga raportet zyrtare të punës së gjykatave dhe prokurorive për vitin 2025 dhe ndarjet buxhetore për to gjatë kësaj periudhe kohore. Ndër të tjera, analizohet numri i lëndëve të pranuara, lëndëve të trashëguara dhe atyre të zgjidhura brenda një viti dhe raporti i tyre me numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar në secilën gjykatë dhe prokurori. Përveç të dhënave për vitin 2025, tek kjo pjesë është analizuar edhe trendi që kanë pasur gjykatat dhe prokuroritë në trajtimin e lëndëve nga viti 2013, periudhë kjo që bëri kthesë në strukturën e re të gjyqësorit në vend. Duhet theksuar se vlerësimi dhe analizimi i numrit të lëndëve të zgjidhura apo të trashëguara brenda një viti në secilën gjykatë dhe prokurori, është bërë pa vlerësuar vështirësinë e zgjidhjes së tyre, apo ndarjen në departamente të ndryshme të gjykatave dhe prokurorive. Kjo pasi qëllimi kryesor në ndërtimin e indikatorëve strukturorë është që të vlerësojë efikasitetin total të punës së gjykatave dhe prokurorive si dhe të vlerësojë performancën individuale sasiore të prokurorëve dhe gjyqtarëve.


Ky edicion ofron edhe krahasime sa i përket të dhënave nga indikatorët e perceptimit dhe indikatorët strukturorë për të parë trendin e perceptimit qytetarë dhe përformancën e gjyqësorit në çështje të njëjta që janë trajtuar në edicionet paraprake, duke ofruar edhe të dhëna nga zhvillimet që kanë mund të kenë ndikim në rritjen ose uljen e trendit për indikatorët përkatës.

PERCEPTIMI QYTETAR MBI INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

NDIKIMI POLITIK NË SISTEMIN E DREJTËSISË


Edhe në këtë edicion, perceptimi qytetar për ndikimin politik në sistemin e drejtësisë mbetet një nga elementet kryesore të vlerësimit. Të dhënat e vitit 2026 tregojnë një rënie të konsiderueshme të përqindjes së qytetarëve të cilët mendojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji. Pra, përderisa në vitin 2025, përqindja e qytetarëve që politikanët dhe personat e tjerë me ndikim politik kanë më pak gjasa të marrin dënime ka qenë 75.6% në vitin 2026, ky perceptim është ulur në shkallën 58.2%. Ndryshimi kaq i madh i shkallës së përqindjes për këtë çështje mund t'i kenë kontribuuar gjykimi në rastin "53 milionëshi" ku është i përfshirë ish-ministri Pal Lekaj, ngritja e aktakuzës për rastin e Rezervave Shtetërore ku është e përfshirë ish-ministrja Rozeta Hajdari, konfirmimi i aktakuzës për korrupsion ndaj zëvendës kryeministrit Fikrim Damka, gjykimi i zyrtarëve të Ministrisë së Bujqësisë në rastet e njohura si "Subvencionet", rasti ish-kryeshefit të KEK-ut, Nagip Krasniqi etj. Rezultatet e perceptimit të këtij indikatori vënë në pah se qytetarët e shohin dhe e vlerësojnë punën e gjyqësorit në raport me rastet ku të përfshirë janë zyrtarë dhe ish-zyrtarë të institucioneve publike të akuzuar për korrupsion, ndonëse për të njëjtit ende nuk ka një vendim të plotfuqishëm rreth fajësisë apo pafajësisë së tyre.

A mendoni se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji?



Në pyetjen vijuese, të anketuarit janë pyetur se cilat institucione kanë më shumë prirje të ndikohen nga politika. Gjykatat janë përzgjedhur më së shpeshti, me 35.5%, pasuar nga Prokuroria me 31.3% dhe Policia me 15.7%. Ndërsa, në edicionin e nëntë të RoLPIK, Gjykatat ishin vlerësuar me 35.1%, Prokuroria me 34% dhe Policia me 17.7%. Nëse e bëjmë një krahasim mes të dhënave mes vitit 2025 dhe 2026, gjykatat vazhdojnë të prijnë si institucione që në vlerësimin qytetarë ndikohen më se shumti nga politika. Përqindja e qytetarëve që shohin ndikimin e politikës tek Prokuroria është rritur në raport më të dhënat e vitit të kaluar, ky ndryshim i perceptimit mund të ketë ndodhur për shkak të ndryshimeve në ligjin për KPK-në dhe zhvillimet që e kanë karakterizuar këtë institucion në fund të vitit 2025 dhe në fillim të vitit 2026, si shkarkimi i UD Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, mungesa e kuorumit, mos mbajtja e mbledhjeve, mospajtimet mes anëtarëve etj.. Në krahasim me të dhënat nga edicioni i kaluar, Policia vlerësohet si institucion më pak i ndikuar nga politika, me një diferencë prej 2 pikë përqindje, nga 17.7% në 15.7%.


Cilat nga këto institucione kanë më shumë prirje të ndikohen nga politika?



MITMARRJA


Perceptimi për praninë e mitmarrjes në institucionet e drejtësisë ka ndryshuar krahasuar me vitin paraprak duke treguar përmirësim. Në anketën e realizuar në muajin korrik 2026, 25.2% e qytetarëve kanë deklaruar se zyrtarët e gjyqësorit kërkojnë apo pranojnë ryshfet. Në vitin e kaluar, përqindja e qytetarëve që mendonin se zyrtarët e institucioneve të drejtësisë pranojnë/kërkojnë mito ka qenë rreth dyfish më e lartë (47.9%). Të dhënat nga ky indikator e reflektojnë perceptimin qytetar mbi përmirësimin e gjyqësorit në raport me llogaridhënien, si element që adreson luftimin e fenomeneve të tilla negative brenda sistemit të drejtësisë. Në ndryshimet rreth perceptimit qytetar lidhur me këtë çështje mund të kenë ndikuar arrestimi i zyrtarëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë nën dyshimin se nuk kishin ekzekutuar vendime gjyqësore me qëllim të pranimit të mitmarrjes nga ana e të dënuarve[4], si dhe gjykimi ndaj ish-kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit, Haxhi Dërguti dhe të tjerëve për ushtrim ndikimi në disa raste gjyqësore[5] etj.

Sipas mendimit tuaj, zyrtarët/ punëtorët e institucioneve të drejtësisë (Policisë, Gjykatave, Prokurorisë, etj) a kërkojnë/pranojnë mito?



Në mesin e atyre që kanë dhënë përgjigje për institucionet ku, sipas tyre, zyrtarët kërkojnë ose pranojnë mito, Gjykatat prijnë me 40.6% të rasteve, pasuar nga Prokuroria me 34.9% dhe Policia me 20.1%. Ndërsa, nga anketa e realizuar në Edicionin e Nëntë shohim një trend të rritjes së perceptimit qytetar se zyrtarët e Policisë kërkojnë ose pranojnë mito nga 18.8% në 20.1%. Bazuar në këtë krahasim, Gjykatat kanë rënë nga 41.6% në 40.6% dhe Prokuroria nga 37.6% në 34.9%.

Zyrtarët / punëtorët e cilit institucion në vazhdim kërkojnë / pranojnë mito?



4 Koha.net, Dy zyrtarët e arrestuar të Gjykatës dyshohen se kanë penguar ekzekutimin e sanksioneve penale, Janar 2024, i qasshëm në linkun: https://www.koha.net/kronike/dy-zyrtaret-e-arrestuar-te-gjykates-dyshohen-se-kane-penguar-ekzekutimin-e-sanksioneve-penale

5 Telegrafi.com, Aktakuzë ndaj ish-kryeprokurorit Haxhi Dërguti për moslajmërim të veprës penale dhe ushtrim ndikimi te një gjykatës, Nëntor 2025, i qasshëm në linkun: https://telegrafi.com/aktakuze-ndaj-ish-kryeprokurorit-haxhi-derguti-per-moslajmerim-te-vepres-penale-dhe-ushtrim-ndikimi-te-nje-gjykates/

EFEKTIVITETI NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT


Siç u theksua edhe në fillim të raportit, Kosova për më shumë se 8 vite nuk ka Strategji Kombëtare Kundër Korrupsionit, kurse Raporti e Komisionit Evropian për vitin 2025, vlerësoi se Kosova ndodhet midis një faze të hershme përgatitjeje dhe një niveli të caktuar përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit, dhe ka shënuar përparim të kufizuar. Ndonëse përfaqësues nga gjyqësori theksojnë se gjatë vitit 2025 është arritur efikasitet në shkallë mbi 100% në trajtimin e rasteve të korrupsionit[6], fatkeqësisht gjykatat ende vazhdojnë të përballen me vonesa në gjykimin e këtyre rasteve, shtyerje të shpeshta të seancave gjyqësore dhe mungesë të aktgjykimeve dënuese për rastet e profilit të lartë. Gjatë këtij viti, Gjykata e Apelit liroi nga akuza të gjithë zyrtarët në rastin "Veteranët"[7], Gjykata e Ferizajt shpalli aktgjykim lirues ndaj ish-kryeinspektorit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës[8], kurse në maj të vitit të kaluar Themelorja në Prishtinë liroi 28 persona të akuzuar për korrupsion dhe vepra tjera penale në rastin e "Patentë shoferëve"[9], ndërkaq Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli aktgjykim dënues në rastin "Subvencionet I"[10]. Përveç këtyre rasteve, në vitin 2026, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës pushoi hetimet për ish-Ministrin Liburn Aliu, Ministren Fitore Pacollin dhe Kryetarin e Komunës së Mitrovicës, Faton Peci, ish-Kryetarin e Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, dhe Kryetarin e Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj.[11]

Për t'i vlerësuar mendimet e qytetarëve në raport me efikasitetin e institucioneve në luftimin e korrupsionit, ata janë pyetur se nga vlera 1 – aspak efikase dhe 5 – shumë efikase, cilin institucion e vlerësojnë që i përgjigjet në mënyrë më efektive korrupsionit.

Policia vazhdon të ketë vlerësimin mesatar më të lartë, me 3.9 në vlerësimin e efektivitetit në luftën kundër korrupsionit, në një shkallë nga 1 deri në 5. Gjykatat vlerësohen me 3.1, Prokuroria me 3.1, ndërsa Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me 3.2. Krahasuar me anketën nga Edicioni i Nëntë i RoLPIK, vërehet një rritje e lehtë e vlerësimit për Policinë nga 3.7 në 3.9, për Gjykatat nga 2.9 në 3.1 dhe për Prokurorinë nga 2.8 në 3.1. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nga 3 në 3.1, Mediat 2 mbeten përafërsisht në të njëjtin nivel. Kurse Organizatat e Shoqërisë Civile kanë trend pozitiv të vlerësimit nga qytetarët nga vlera 3.1 në 3.3. Ky trend pozitiv në të gjitha institucionet publike është një sinjal i rëndësishëm mbi besimin e qytetarëve sa i përket efikasitetit në luftën kundër korrupsionit.

Si i vlerësoni institucionet në vazhdim për efektivitetin në luftën kundër korrupsionit?

1 - Aspak i kënaqur dhe
5 - Plotësisht i kënaqur



6 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Takimi i 358-të, i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, janar 2026, min: 4:16:00 – 4:19:00, link: https://www.youtube.com/watch?v=bZnzenDbNBw&t=15068s

7 VOX, RASTI "VETERANËT" Gjykata e Apelit liron nga akuzat Agim Çekun dhe 9 të dënuarit e tjerë, shtator 2026, link: https://voxkosova.com/rasti-veteranet-gjykata-e-apelit-liron-nga-akuzat-agim-cekun-dhe-9-te-denuarit-e-tjere/

8 Kallxo.com, Bedri Halimi shpallet i pafajshëm në rastin "Brezovica", shtator 2026, link: https://kallxo.com/lajm/bedri-halimi-shpallet-i-pafajshem-ne-rastin-brezovica

9 Koha.net, Lirohen 28 të akuzuarit për korrupsion dhe vepra tjera penale në rastin e "Patentë shoferëve", maj 2025, link: https://www.koha.net/kronike/lirohen-28-te-akuzuarit-per-korrupsion-dhe-vepra-tjera-penale-ne-rastin-e-patente-shofereve


10 Dukagjini.com, Dënohen 12 të akuzuar në rastin "Subvencionet 1" me 37 vjet burgim dhe 171 mijë euro gjobë, shator 2025, link: https://www.dukagjini.com/denohen-12-te-akuzuar-ne-rastin-subvencionet-1-me-37-vjet-burgim-dhe-171-mije-euro-gjobe/

11 Sistemi Prokurorial, REAGIM I PROKURORISË SPECIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Lidhur me artikujt e publikuar në portalet "Vox Kosova" dhe "Nacionale", tetor 2026, link: https://ps.prokuroria-rks.org/artikulli/21361

GATISHMËRIA PËR TË RAPORTUAR KORRUPSIONIN DHE VEPRAT TJERA PENALE


Përveç se detyrim ligjor për të raportuar rastet e korrupsionit dhe veprat e tjera penale, bashkëpunimi i qytetarëve me organet e drejtësisë paraqet element të rëndësishëm të vlerësimit të punës së tyre dhe besimit që institucionet kanë krijuar tek qytetarët. Nga të anketuarit, 69.1% shprehen të gatshëm të raportojnë një rast korrupsioni ose krimi, ndërsa 21.2% deklarojnë se nuk do ta raportonin dhe 9.7% nuk e dinë nëse do të raportonin ose nuk janë përgjigjur fare në pyetje. Krahasuar me anketën nga edicioni i nëntë, gatishmëria për raportim ka rënë me 9.5 pikë përqindjeje, nga 78.6% në 69.1%. Në të njëjtën kohë, është rritur përqindja e atyre që nuk do të raportonin, nga 15% në 21.2%. Rënia e gatishmërisë së qytetarëve për të raportuar rastet e krimit paraqet një sinjal shqetësues i cili kërkon adresim nga ana e secilit institucion të drejtësisë.

Në qoftë se do të vërenit ndonjë rast të korrupsionit apo krimit (vjedhje, dhune, etj), a do të ishit të gatshëm ta raportonit?



Përveç gatishmërisë për raportim, anketa ka synuar të shoh se në cilin institucion qytetarët do të raportonin. Bazuar në të dhënat e siguruara nga anketa, Policia mbetet institucioni kryesor ku do të drejtoheshin qytetarët, me 87.4%. Pas saj renditet Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me 6.4%, Media me 2.6%, Prokuroria me 1.5% dhe Gjykata me 1.7%. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me ato të vitit paraprak, rezulton se Policia ka rritur shkallën e besimit të qytetarëve për të raportuar nga 80.8% në 87.4%, kurse Prokuroria dhe Gjykatat kanë shënuar rënie nga 2.7% në 1.5%, përkatësisht nga 2.3% në 1.7%. Ky rezultat është në përputhje me të dhënat e anketës që vlerësojnë perceptimin qytetar mbi efikasitetin institucional ndaj korrupsionit dhe veprave tjera penale. Pra, edhe në këtë pyetje, nga përgjigjet e pranuara shihet se besimi qytetar në gjykata dhe prokurori ka shënuar rënie sa i përket gatishmërisë së qytetarëve për raportimin e rasteve të ndryshme penale, ndërsa është rritur besimi për raportim në Polici. Kurse, lidhur me përqindjen e ultë për raportim të veprave penale në Prokurori e Gjykata, kjo mund të jetë si pasojë se qytetarët nuk i shohin shumë efikase këto institucione në luftimin e kriminalitetit dhe se ka mungesë të informimit lidhur me këtë mundësi.

Nëse po, në cilin institucion do ta




SHËRBIMET NGA INSTITUCIONET E DREJTËSISË


Pyetja nëse qytetarët janë të përfshirë në procese gjyqësore dhe nëse po në çfarë cilësie është shtuar për herë të parë në edicionin e kaluar dhe është përdorur edhe për këtë edicion. Kjo çështje është parë e rëndësishme për faktin se në vazhdimësi gjyqësori është karakterizuar me numër të madh të rasteve, me theks të veçantë lëndë të natyrës civile, prandaj me këtë pyetje është synuar të shihet nëse numri i madh i lëndëve lidhet me numrin e madh të qytetarëve apo që një pjesë e qytetarëve kanë më shumë se një lëndë aktive në gjykatë.

Nga të anketuarit, 4.8% deklarojnë se aktualisht janë palë në ndonjë proces gjyqësor, ndërsa 91.4% nuk janë palë dhe 3.7% refuzojnë të përgjigjen. Ndërsa në edicionin e nëntë përqindja e personave që deklaruan se ishin palë në një proces gjyqësor ishte 6%, kurse e atyre nuk ishin palë në procese gjyqësore ishte 91.2%. Kurse, të pyetur se në çfarë cilësie janë pjesë e proceseve gjyqësore që zhvillohen në gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, 45.3% u deklaruan si paditës ndërsa 40.6% si palë e dëmtuar. Nga këto të dhëna mund të vijmë në përfundim se numri i madh i lëndëve gjyqësore jo domosdoshmërisht nënkupton që shumë qytetarë janë pjesë e proceseve gjyqësore, por më shumë është e shprehur dukuria kur një qytetar i vetëm ka disa raste aktive në gjykata.

A jeni aktualisht palë në ndonjë proces gjyqësor?



Nëse po, në çfarë cilësie jeni të përfshirë?



5.7%
I/e akuzuar

40.6%
I/e dëmtuar


45.3%
Paditës/e

6.6%
Dëshmitar/e

1.8%
Tjetër

Për qëllime të ndryshme, qoftë udhëtimi ose punësimi, qytetarët shpesh obligohen që të pajisen me dokumente sa i përket gjendjes penale, shërbime këto të cilat ofrohen nga ana e policisë, prokurorisë dhe gjykatave. Të pyetur në lidhje me shërbimet e marra nga institucionet e drejtësisë, 23.3% e të anketuarve deklarojnë se kanë marrë ose pranuar shërbime nga Policia, Prokuroria apo Gjykata gjatë pesë viteve të fundit. Ndërsa, në krahasim me anketën paraprake, përqindja e atyre që kanë pranuar shërbime nga këto institucione ka rënë për 6.6 pikë përqindje.

A keni marrë/pranuar shërbime gjatë 5 viteve të fundit nga institucionet e drejtësisë (Policia, Prokuroria, Gjykata)?




KËNAQSHMËRIA E QYTETARËVE ME PERFORMANCËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Performanca e sistemit të drejtësisë në trajtimin efikas dhe profesional të rasteve paraqet element të rëndësishëm për të vlerësuar se sa qytetarët janë të kënaqur me punën e gjyqësorit. Për këtë, qytetarët e anketuar për punën e institucioneve të drejtësisë nga një shkallë vlerësimi 1 deri në 5, i kanë dhënë Policisë vlerësimin më të lartë me 3.8 ndërsa Gjykatat dhe Prokuroria vlerësohen me 3 përkatësisht 2.9. Krahasuar me edicionin e nëntë të RoLPIK, të tre institucionet shënojnë rritje të lehtë: Policia nga 3.6 në 3.8, Gjykatat nga 2.7 në 3 dhe Prokuroria nga 2.7 në 2.9. Ky trend është një sinjal pozitiv se efikasiteti statistikor i gjyqësorit, i trajtuar në kapitullin e indikatorëve strukturorë të këtij edicioni, ka reflektuar edhe në nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e këtyre institucioneve.

Sa jeni të kënaqur me punën/ performancën e këtyre institucioneve?

1 – Aspak i kënaqur dhe
5 – Plotësisht i kënaqur




VLERËSIMI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA GJYQËSORI

Digjitalizimi i shërbimeve gjyqësore paraqet një mundësi të shpejtë, efikase dhe ekonomike për qytetarët, por edhe ulje të ngarkesës për administratën gjyqësore. Duke qenë se tashmë gjyqësori ofron disa shërbime përmes platformës e-Kosova, qëllimi ka qenë të shihet opinioni publik mbi këto çështje. Ofrimi në mënyrë elektronike i shërbimeve të gjyqësorit, përfshirë mekanizmin për përcjelljen e statusit të lëndëve dhe nxjerrjen e Certifikatës mbi Dënimet Penale, mes vlerave 1 dhe 5, është vlerësuar me një mesatare prej 3.5. Ndërsa, në anketën e realizuar në 2025, ofrimi i këtyre shërbimeve në mënyrë elektronike ishte vlerësuar me 3.3. Kujtojmë që ofrimi i këtyre dy shërbimeve tërësisht në mënyrë digjitale është duke u mundësuar përmes platformës e-Kosova që nga fundi i vitit 2022.[12] Po ashtu, bazuar në rëndësinë e digjitalizimit dhe aplikimit të tij nga ana e gjyqësorit, në muajin tetor 2026, KGJK njoftoi edhe për lansimin e dy shërbimeve të reja, të cilat mundësojnë gjenerimin dhe shkarkimin online të Certifikatës mbi dënimet penale, për personat fizik me leje qëndrim në Republikën e Kosovës, dhe për personat juridik, përmes personave fizik të autorizuar.[13] Duke qenë se këto shërbime po marrin vlerësim pozitiv nga ana e qytetarëve, KGJK-së i mbetet që të promovojë dhe të mundësojë edhe më shumë shërbime përmes kësaj forme.

Si e vlerësoni ofrimin e shërbimeve të gjyqësorit - si mekanizmi për përcjelljen e statusit të lëndëve në Gjykatë dhe nxjerrja e Certifikatës mbi Dënimet Penale - në mënyrë digjitale?

1 – Aspak i kënaqur dhe
5 – Plotësisht i kënaqur



12 Kosova Press. Certifikata e gjendjes civile nga tani nxirret online përmes E-Kosova. 23 dhjetor 2022. https://kosovapress.com/certifikata-e-gjendjes-civile-nga-tani-nxirret-online-permes-e-kosova; Nacionale. Lëndët në raste ligjore, qytetarët do të informohen përmes KGJK-së dhe platformës "eKosova". 25 nëntor 2022. https://www.nacionale.com/sq/articles/lendet-ne-raste-ligjore-qytetaret-do-te-informohen-permes-kgjk-se-dhe-platformes-ekosova

13 Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Njoftim, Tetor 2026, link: https://www.gjyqesori-rks.org/2026/10/07/njoftim-57/

Bazuar edhe në krahasim mes të dhënave në vitin 2025 dhe 2026, shihet se shkalla e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet online të gjyqësorit ka trend pozitiv, padyshim kësaj i ka kontribuar ofrimi i këtyre shërbimeve në mënyrë shumë efikase si dhe vullneti institucional për digjitalizim të shërbimeve të tjera që lehtësojnë procedurën e pajisjes së qytetarit me dokumente zyrtare, ulin barrën administrative dhe volumin e punës në administratën gjyqësore.


TRAJTIMI I BARABARTË I QYTETARËVE NGA SISTEMI I DREJTËSISË

Një nga parimet bazë të veprimtarisë së institucioneve të drejtësisë është trajtimi i barabartë i qytetarëve, pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, statusin shoqërorë apo bindjet personale. Por, kjo nuk duhet të mbetet vetëm si dispozitë e shkruar por e njëjta duhet të aplikohet në praktikë me qëllim që t'i garantohet secilit mbrojtje efektive gjyqësore. Perceptimi për trajtimin e barabartë të personave dhe grupeve të margjinalizuara është matur në një shkallë nga 1 deri në 5. Qytetarët kane vlerësuar me një mesatare prej 3.03 sistemin e drejtësisë për këtë çështje. Kjo tregon një ndryshim të vogël nga edicioni i nëntë, ku masa më e madhe e të anketuarve kishin vlerësuar me 3 dhe mesatarja e vlerësimit të performancës ishte 2.98. Nga ky vlerësim, shihet se perceptimi qytetar nuk ka ndryshuar në lidhje me trajtimin e grupeve të margjinalizuara nga institucionet e drejtësisë.

Ju lutem na tregoni se sa pajtoheni me deklaratën në vazhdim:

"Institucionet e drejtësisë i trajtojnë njësoj personat/grupet e margjinalizuara si: gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, personat me të ardhura minimale"

1 - Aspak nuk pajtohem; 2 - Nuk pajtohem;
3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem;
5 - Plotësisht pajtohem



PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE


Të gjitha institucionet kanë për obligim që vendimet e tyre t'i marrin në mënyrë plotësisht të pavarur, për të garantuar para qytetarëve vendimmarrje të drejtë dhe pa asnjë ndikim të jashtëm ose të brendshëm. Për të vlerësuar perceptimin qytetar në raport me këtë çështje, ata janë pyetur se cilat institucione janë në gjendje që veprimtarinë e tyre ta kryejnë në mënyrë të pavarur. Të anketuarit e vlerësuan Policinë si institucioni i parë që është në gjendje të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur (43.8%), pasuar nga Gjykatat me 23.5% dhe Prokuroria me 19%. Po të krahasohet me edicionin e kaluar, vlerësimi për këto institucione është i ngjashëm sikurse edhe me të dhënat nga edicioni i vitit 2025 të RoLPIK, ku Policia kishte 43.7%, Gjykatat 21.2% dhe Prokuroria 18.3%. Këto rezultate përputhen me ato të ndikimit politik në punën e insititucioneve, prandaj duhet fokus i këtyre mekanizmave që krahas trajtimit të barabartë të palëve në procedurë, të dëshmojnë edhe pavarësi gjatë veprimtarisë së tyre.

Sipas mendimit tuaj, në praktikë, cilat nga institucionet e Kosovës në vazhdim janë në gjendje të kryejnë detyrat/ përgjegjësitë e tyre në mënyrë të pavarur?



Në lidhje me bazën mbi të cilën gjyqtarët marrin vendime, 43.9% e të anketuarve konsiderojnë se shumica e gjyqtarëve bazohen më shumë në faktet e disponueshme dhe kornizën ligjore. Ndërkohë, 29.8% përmendin ndikimin e interesave private ose korrupsionit, ndërsa 24.8% ndikimin e zyrtarëve të lartë ose personave me influencë politike. Nëse i krahasojmë të dhënat me vitin paraprak rezulton se është rritur përqindja e qytetarëve që mendojnë se vendimet gjyqësore bazohen në fakte dhe kornizën ligjore (nga 39.1% në 43.9%) kurse ka rënë përqindja e qytetarëve të cilët mendojnë se korrupsioni dhe politika i determinojnë vendimet e gjyqtarëve. Ky trend duhet të shihet pozitiv ndonëse as gjysma e qytetarëve ende nuk është e bindur se vendimmarrja e gjyqtarëve është në kuadër të kornizës ligjore që aplikohet në vendin tonë.


Sipas mendimit tuaj, gjatë marrjes së vendimit shumica e gjyqtarëve në Kosovë bazohen më shumë në:




PËRMIRËSIMI I GJYQËSORIT

Në 5 vitet e fundit, sistemi gjyqësor në Kosovë u karakterizua me disa zhvillime të rëndësishme, me theks të veçantë në aspektin legjislativ. Ligji i ri për Prokurorinë Speciale, ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, Ligji për Këshillin Prokurorial, miratimi i ligjit për Gjykatën Komerciale dhe për Gjykatën Administrative ishin disa nga aktet ligjore që synonin rritjen e efikasitetit institucional dhe krijimin e mekanizmave për rezultate konkrete në raste gjyqësore. Nga anketa e realizuar rezulton se 35.6% e qytetarëve konsiderojnë se sistemi i drejtësisë është përmirësuar gjatë pesë viteve të fundit. Në anën tjetër, 47.7% nuk kanë vërejtur përmirësim, ndërsa 16.7% nuk e dinë ose nuk janë përgjigjur. Krahasuar me edicionin paraprak, përqindja e atyre që kanë vërejtur përmirësim ka rënë nga 38% në 35.6%. Ky ndryshim është relativisht i vogël dhe sugjeron se perceptimi i qytetarëve për sistemin e drejtësisë mbetet kryesisht i pandryshuar. Një ndër faktorët që mund ta shpjegojë këtë është hendeku ndërmjet reformave institucionale dhe rezultateve konkrete që qytetarët i përjetojnë në praktikë. Pra, ndonëse u miratuan ligje të reja dhe u krijuan mekanizma të rinj, qytetarët serish presin me vite të tëra për një vendim gjyqësor, e fatkeqësisht edhe këto vendime shpeshherë nuk shihen si të bazuara në fakte por në presione publike apo interesa personale.


Sipas mendimit tuaj, a është përmirësuar sistemi i drejtësisë gjatë 5 viteve të fundit?





Në mesin e atyre që konsiderojnë se sistemi i drejtësisë është përmirësuar, llogaridhënia dhe transparenca paraqesin dimensionin që është përmirësuar më së shumti, me 35.6%. Pas saj renditet mbyllja ose zgjidhja më e shpejtë e rasteve me 27.5%, hetimi i rasteve të korrupsionit me 21.1% dhe ndikimi më i vogël i politikanëve mbi gjyqtarët me 15.1%. Marrë nga krahasimi me edicionin e kaluar, llogaridhënia dhe transparenca kanë shënuar rritje nga 31.4% në 35.6%. Këto rezultate paraqesin sinjal pozitiv dhe vlerësim të rritjes së transparencës së sistemit të drejtësisë sidomos për faktin se mbledhjet e KGJK-së dhe KPK-së vazhdojnë të mbesin publike, organizimi i konferencave për media me rastin e ngritjes së aktakuzave për çështje me interes publik, mbajtja e takimeve publike të gjykatave me qytetarë, publikimi i raporteve statistikore dhe prezenca më e madhe në rrjete sociale përmes llogarive zyrtare të sistemit prokurorial dhe të gjykatave e të tjera.

Nëse po, cili nga këto dimensione të sistemit të drejtësisë është përmirësuar më së shumti?



35.6%
Llogaridhënia dhe transparenca

27.5%
Mbyllja/zgjidhja më e shpejtë e rasteve

15.1%
Ndikim më i vogël i politikanëve mbi gjyqtarët

21.1%
Hetimi i rasteve të korrupsionit

0.7%
Tjetër


KUSHTET E PUNËS SË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Gjatë kryerjes se të gjitha autorizimeve që ua njeh ligji, gjyqtarët dhe prokurorët shpeshherë përballen edhe me presione të ndryshme të cilat kalojnë në nivel të kërcënimeve apo frikësimeve. Këto situata përveç që mund të cenojnë sigurinë fizike të këtyre zyrtarëve, mund të shihen edhe si mundësi që vendimmarrja e tyre të mos jetë e pavarur dhe e paanshme. Prandaj, duke qenë se KGJK dhe KPK e kanë për obligim që të garantojnë pavarësinë e gjyqësorit dhe të mbrojnë gjyqtarët e prokurorët nga çfarëdo forme e ndikimit, në anketë kemi pyetur qytetarët se a pajtohen që këto institucione kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët apo prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet apo frikësimet. Në mes vlerave 1 – aspak nuk pajtohem dhe 5 – pajtohem plotësisht, mesatarja e përgjigjeve rezulton me vlerën 3.3, që paraqet një nivel pak më pozitiv sesa në edicionin e kaluar ku kjo mesatare ishte 3. Këtij trendi mund t'i kenë kontribuar reagimet publike të gjyqësorit në rastet kur akterë të ndryshëm përdoren gjuhë fyese ndaj gjyqtarëve[14] ose dënimi ndaj të akuzuarve për kanosjen e gjyqtarit Mentor Bajraktari e prokurorit Afrim Shefkiu.[15]

Ju lutem na tregoni se sa pajtoheni me deklaratën në vazhdim:

"Gjykatat/prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët/prokuroret nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet"

1 - Aspak nuk pajtohem; 2 - Nuk pajtohem;
3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem;
5 - Plotësisht pajtohem



14 KGJK, KGJK dënon gjuhën linçuese dhe sulmet denigruese ndaj gjyqtares Edita Çanta, maj 2026, i qasshëm në linkun: https://www.facebook.com/share/p/1E2WjxtsN9/

15 Kallxo.com, Momenti kur Gjykata e dënon Egzon Azemin dhe dy të tjerë për kanosjen e prokurorit Afrim Shefkiut dhe gjyqtarit Mentor Bajraktari. Gjykata e liron Arlind Manxhukën, Mars 2025, link: https://www.facebook.com/share/v/19s7H6sZ3d/

VETTINGU DHE KONFISKIMI I PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME NË PROCEDURË CIVILE

35.3% e të anketuarve konsiderojnë se mungesa e vullnetit politik është arsyeja kryesore për mosrealizimin e iniciativave si procesi i vetingut dhe Byroja për konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme. Kjo pasohet nga mungesa e konsensusit politik me 18.3%, draftimi jo adekuat i legjislacionit me 14.1% dhe vonesat në vlerësimin e kushtetutshmërisë së projektligjeve me 11.7%. Në krahasim me të dhënat e vitit 2025, mungesa e vullnetit politik po ashtu printe si arsye që qytetaret e vlerësonin pengesë për jetësimin e këtyre reformave me 37.4%, ndërsa këtë vit vërehet një trend i rritjes së perceptimit qytetar mbi draftimin e nismave ligjore si arsye për mos procedimin tutje të amendamenteve të Vettingut dhe Projektligjit të Byrosë.

Koncept dokumenti për Vetingun në sistemin e drejtësisë në Kosovë ka filluar në vitin 2021[16], kurse amandamentet kushtetuese që i hapin rrugë ligjit për vettingun ende nuk kanë arritur të miratohet në Kuvend. Ndërkaq, konfiskimi i pasurisë së pajustifikueshme është iniciativë e Ministrisë së Drejtësisë me qëllim të krijimit të një mekanizmi që do ta menaxhonte këtë proces. Projektligji për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, i cili është rrëzuar dy herë nga Gjykata Kushtetuese, për herë të tretë është miratuar në Qeveri, më 26 shtator 2026.[17] Më pas, me 5 tetor 2026, Projektligji u miratua në lexim të parë kurse me 29 tetor 2026, u miratua në lexim të dytë.[18] Para miratimit të këtij Projektligji, GLPS publikoi një analizë juridike ku konstatoi se drafti i propozuar kishte nevojë për ndërhyrje dhe se dispozitat e tij cenonin sigurinë juridike të qytetarëve. [19] Po ashtu, dy ditë para se të procedohej për miratim në Kuvend, GLPS kishte bërë thirrje që Projektligji të kthehej për rishqyrtim tek Komisioni për Legjislacion për shkak të procedurës që ishte ndjekur mes dy leximeve dhe për përmbajtjen e këtij akti.[20]

Cilat mendoni se janë arsyet e mosrealizimit deri më tani të iniciativave të qeverisë së Kosovës (Ministrisë së Drejtësisë), si procesi i Vettingut dhe Byroja për konfiskimin e pasurisë së pajustifikueshme?



18.3%
Mungesa e konsensusit politik

37.4%
Mungesa e vullnetit politik

11.8%
Draftimi jo adekuat i legjislacionit

16.8%
Vonesat në vlerësimin e kushtetueshmërisë së projektligjeve

0.7%
Tjetër

15%
Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem

16 Ministria e Drejtësisë, Koncept Dokumenti për Zhvillimin e Procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë, i qasshëm në https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/06/09E907A6-06B2-4DBF-AB8B-E2793F4B9049.pdf

17 Kallxo.com, Qeveria miraton Projektligjin për Byronë e Konfiskimit të Pasurisë së Pajustifikueshme, Gërvalla jep detaje, https://kallxo.com/lajm/qeveria-miraton-projektligjin-per-byrone-e-konfiskimit-te-pasurise-se-pajustifikueshme-gervalla-jep-detaje/

18 Koha.net, Miratohet Ligji për Byronë e konfiskimit të pasurisë, tetor 2026, i qasshëm në linkun: https://ëëë.koha.net/arberi/miratohet-ligji-per-byrone-e-konfiskimit-te-pasurise


19 Naser Shamolli, Konfiskimi i Pasurisë së Pajustifikueshme: Çka nuk u rregullua as këtë herë, i qasshëm në https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2026/09/GLPS_042026_ByrojaeKonfiskimit.pdf; dhe Klan Kosova, Projektligji për Byronë: Mangësitë e evidentuara nuk u adresuan, i qasshëm në https://klankosova.tv/projektligji-per-byrone-mangesite-e-evidentuara-nuk-u-adresuan-video

20 GLPS, GLPS kërkon adresimin e mangësive para votimit në lexim të dytë të Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme, tetor 2026, i qasshëm në linkun: https://legalpoliticalstudies.org/glps-calls-for-legal-safeguards-before-vote-on-asset-confiscation-law/

EFIKASITETI I GJYQËSORIT

Gjyqësori në vazhdimësi është përballë kritikave për efikasitet të ulët dhe vonesa në trajtimin e çështjeve gjyqësore të palëve. Kjo situatë ka nxitur diskutimet në publik për krijimin e mekanizmave të rinj me qëllim që qytetarët të gëzojnë të drejtën që çështja e tyre të trajtohet brenda një kohe të arsyeshme. Pas krijimit të Gjykatës Komerciale, nga data 5 maj 2026 u funksionalizua edhe Gjykata Administrative, kurse në proces është edhe krijimi i një mekanizmi të ri për konfiskim civil. Prandaj, për të parë se si vlerësohen këto zhvillime nga ana e qytetarëve, në këtë edicion për herë të parë kemi pyetur qytetarët se cila është masa më adekuate për rritjen e efikasitetit të gjyqësorit. Nga përgjigjet e të anketuarve, mbështetja dhe ruajtja e pavarësisë së institucioneve aktuale vlerësohet masë më adekuate (48.2%) sesa krijimi i institucioneve të reja të specializuara (40.7%). Kurse 11% e të anketuarve nuk kanë dhënë përgjigje. Këto të dhëna tregojnë se qytetarët vlerësojnë se Kosova ka institucione të mjaftueshme të gjyqësorit dhe mundësi për efikasitet më të lartë, por e shohin më të arsyeshme që ato të mbështeten dhe të ruhet pavarësia e tyre sesa të krijohen institucione të reja të specializuara.

Cilën nga këto opsione e vlerësoni të domosdoshme për rritjen e efikasitetit të gjyqësorit?”



48.2%
Mbështetja dhe ruajtja e pavarësisë së institucioneve aktuale


40.7%
Krijimi i institucioneve të reja të specializuara

11%
Nuk e di / Pa përgjigje

NIVELI I SIGURISË NË VEND

Në anketën e realizuar në korrik të vitit 2026, qytetarët janë pyetur se sa e vlerësojnë nivelin e sigurisë në vend në një kufi mes vlerave 1 – aspak i sigurt dhe 5 – plotësisht i sigurtë. Nga mesatarja e përgjigjeve rezulton se niveli i sigurisë në vlerësimin qytetarë arrin mesataren 3.38, një rënie e lehtë nga vlera 3.43 sa ishte në vitin e kaluar. Marrë në kontekstin e viteve të fundit, vlen të theksohet se në prill 2026, disa persona u dënuan për sulm të armatosur në Banjskë të vitit 2023, e po ashtu gjatë këtij viti pati edhe arrestime të personave të dyshuar për spiunazh. Këto zhvillime, së bashku me tensionet e vazhdueshme në veri, përbëjnë kontekst të rëndësishëm për interpretimin e vlerësimit prej 3.38, i cili pasqyron perceptimin e qytetarëve dhe jo domosdoshmërisht nivelin objektiv të sigurisë..

Në një shkallë nga 1 deri në 5
(1 – aspak dhe 5 - plotësisht),
si i vlerësoni nivelin e sigurisë në vend?




BESUESHMËRIA NDAJ DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Në këtë anketë të edicionit të dhjetë, e realizuar 2 muaj para vendimit në rastin “Thaqi dhe të tjerët”, besueshmëria e qytetarëve ndaj Dhomave të Specializuara të Kosovës në kufirin mes vlerave 1 dhe 5, është vlerësuar me një mesatare prej 2.52. Kjo mesatare në anketën e edicionit të nëntë ishte 2.56, pra ka një rënie të besimit të qytetarëve në këtë mekanizëm ndërkombëtar.

Më 20 prill 2026, Institucioni i Avokatit të Popullit publikoi një vlerësim paraprak të

hartuar nga Komiteti i Odës së Avokatëve për të Drejtat e Njeriut të Anglisë dhe Uellsit (BHRC), i cili ngriti çështje lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimit, mundësitë e kufizuara për lirim të përkohshëm, monitorimin e komunikimeve me familjarët dhe avokatët, pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore, pranueshmërisë e provave, barazinë e armëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes, si dhe bazën ligjore të ndjekjes penale. Raporti theksoi gjithashtu mungesën e mekanizmave efektivë të transparencës dhe llogaridhënies, duke rekomanduar forcimin e mbikëqyrjes së pavarur të proceseve gjyqësore..[21]

Në një shkallë nga 1 deri në 5
(1 – aspak dhe 5 - plotësisht),
deri në çfarë mase i besoni Dhomave të Specializuara të Kosovës që të ofrojnë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe të pavarur?




DËNIMET NË RASTET E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS NË BAZA GJINORE

Fenomeni i dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë mbetet një nga shqetësimet e vazhdueshme si për qytetarët ashtu edhe për institucionet publike të mandatuara për ta parandaluar dhe luftuar këtë fenomen. GLPS përmes projektit "Just React", në mars 2026, publikoi një raport monitorimi ku ndër të tjera theksohet se politika e ultë ndëshkimore, recidivizmi, shtyerja/anulimi i seancave janë disa nga elementet që po i karakterizojnë rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në vendin tonë. Po ashtu, raporti thekson se rreth 90% e të akuzuarve shpallen fajtorë, vetëm 1 në 3 prej tyre merr dënim efektiv, kurse për pjesën tjetër shqiptohen dënime me kusht dhe gjoba.[22] Në vitin 2026, qytetarët i vlerësojnë dënimet për rastet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore me një mesatare prej 3.06 nga 5. Qytetarët e kishin vlerësuar ngjashëm këtë çështje edhe në edicionin paraprak të RoLPIK me vlerën mesatare 3. Duhet të theksohet se në vitin 2025, në Policinë e Kosovës ishin raportuar 2,815 raste të dhunës në familje ku numri i viktimave gra ishte 2,137.[23]

Në vitin 2025, gjykatat e Kosovës kishin pranuar 1007 raste për veprën penale "dhunë në familje", ndërsa gjykata ka dhënë vendim fajësie në 495 raste dhe vetëm 145 nga ta kanë marrë dënim efektiv me burgim.[24]Padyshim, qasja institucionale në raport me këtë fenomen duhet të jetë më serioze, duke e trajtuar secilin rast me profesionalizëm që nga momenti kur raportohet në polici, gjatë ngritjes së aktakuzës në prokurori dhe gjykimit pranë gjykatës përkatëse. Po ashtu, obligim i Qeverisë dhe Kuvendit mbetet mbështetja e shërbimit korrektues, mbrojtësve të viktimave, strehimoreve dhe secilit mekanizëm që ofron shërbime ndaj viktimave të dhunës në familje.

Në një shkallë nga 1 deri në 5 (1 – aspak dhe 5 - plotësisht), sa meritore (parandaluese) konsideroni që janë dënimet për rastet e dhunës në familje / baza gjinore?



21 Kallxo.com, Raporti i Avokatit të Popullit për Dhomat e Specializuare në Hagë, ngrit shqetësime për punën e Gjykatës Speciale, i qasshëm në https://kallxo.com/lajm/raporti-i-avokatit-te-popullit-per-dhomat-e-specializuare-ne-hage-ngrit-shqetesime-per-punen-e-gjykates-speciale/

22 GLPS, Performanca dhe Mangësitë: Trajtimi Institucional i Dhunës në Familje në 2025, Mars 2026, i qasshëm në linkun: https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2026/04/Gender-based-violence_ALB_02.pdf

23 Ibid.

24 Ibid.

VLERËSIMI I PUNËS SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

VLERËSIMI I PUNËS SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Sikurse edicionet e kaluara, në bazë të metodologjisë së RoLPIK, vlerësimi i punës së sistemit të drejtësisë edhe në këtë edicion bazohet në analizën e raporteve zyrtare të gjykatave dhe prokurorive të publikuara për vitin 2025. Këto raporte ofrojnë të dhëna mbi numrin e lëndëve të zgjidhura, efikasitetin e punës, ngarkesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Analiza përfshinë të dhënat për të gjitha institucionet e gjyqësorit në vend, përveç Gjykatës Administrative, e cila u funksionalizua me 5 maj 2026. Pra, ky indikator analizon punën statistikore të Gjykatës Supreme të Kosovës (GJS), Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), Gjykatës së Apelit të Kosovës (GJA), shtatë gjykatave themelore (GJTH) dhe Gjykatës Komerciale (GJK). Ndërsa, vlerësimi i punës së sistemit prokurorial përfshinë Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), Prokurorinë e Apelit (PA), Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe shtatë prokuroritë themelore (PTH). Indikatorët e përdorur për këtë vlerësim masin vetëm pjesën sasiore të punës së gjykatave dhe prokurorive gjatë një viti kalendarik; ato nuk pasqyrojnë as nivelin e vështirësisë së rasteve, as mënyrën e trajtimit të tyre.

Pjesa e fundit e këtij indikatori i dedikohet buxhetit të gjyqësorit, një nga çështjet për të cilat KGJK dhe KPK në vazhdimësi kanë shprehur pakënaqësi me arsyetimin se as ekzekutivi e as legjislativi nuk kanë marrë për bazë kërkesat e tyre buxhetore përgjatë viteve. Prandaj, për të kuptuar në çfarë mase është prioritizuar sistemi i drejtësisë në raport me buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës, në këtë indikator do të analizohet buxheti i gjyqësorit për vitin 2025 dhe raporti i këtij buxheti me vitet paraprake.

PERFORMANCA E PROKURORIVE

PERFORMANCA E PROKURORIVE

Institucioni i Prokurorit të Shtetit në Kosovë përbëhet nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), Prokuroria e Apelit (PA) dhe shtatë Prokuroritë Themelore (PTH). Gjatë vitit 2025, Prokurori i Shtetit ka pasur si të trashëguara gjithsej 75,240 kallëzime penale ndërsa ka pranuar në punë edhe 45,295 lëndë penale të reja.[25] Nga totali prej 120,535 lëndëve aktive, janë zgjidh 42,123 lëndë, pra një shkallë efikasiteti prej 93% në raport me lëndët e pranuara dhe vetëm 35% nga totali i rasteve në punë. Rrjedhimisht, në vitin 2026, Prokurori i Shtetit e ka filluar punën me 78,412 lëndë penale që presin trajtim, dhe me këtë trend të efikasitetit prokurorive ju duhen edhe rreth 3 vite për të trajtuar të gjitha lëndët që i kanë në punë, me kusht që nuk pranojnë raste të reja.

Bazuar në të dhënat mbi efikasitetin e zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët e pranuara gjatë vitit 2025, rezulton se ZKPSH dhe PA kanë arritur rezultat 100%, pra duke zgjidhur numër të lëndëve aq sa i kanë pranuar. Ndërsa, ndryshimin më të madh pozitiv e ka bërë PSRK e cila nga një efikasitet prej 63% në vitin 2024, në vitin 2025 ka shënuar efikasitet në shkallë 83% (506 lëndë të zgjidhura nga 611 të pranuara). Po ashtu, një sinjal pozitiv të efikasitetit e kanë treguar edhe prokuroritë themelore të cilat nga 32,832 lëndë të pranuara kanë zgjidhur 29,766 prej tyre, pra një shkallë prej 91%, më e larta që nga viti 2021.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur përqindjet e efikasitetit për secilën prokurori. Efikasiteti është llogaritur duke krahasuar numrin e lëndëve që kanë arritur të përfundojnë prokuroritë, në raport me numrin e lëndëve që ato kanë pranuar brenda vitit kalendarik.

Tabela 1. Përqindja e efikasitetit të Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuara (2013 – 2025)

Viti	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit	Prokuroria Speciale	Prokuroria e Apelit	Prokuroritë Themelore
2025	100	83	100	92
2024	100	62	100	87
2023	101	87	100	76
2022	100	75	100	84
2021	100	70	102	99
2020	100	153	100	118
2019	100	59	116	153
2018	102	105	99	127
2017	98	93	100	112
2016	101	192	100	112
2015	102	125	100	94
2014	96	51	100	71
2013	101	94	100	80

25 Sistemi Prokurorial, Raporti vjetor i Prokurorit të Shtetit 2025, i qasshëm në linkun: https://prokuroria-rks.org/uploads/2026/06/c1ca92bb-7b2d-477d-99ba-b551067e26af_RAPORTI%20VJETOR%20I%20PROKURORIT%20TE%20SHTETIT%202025-FINAL.pdf

NGARKESA E PROKURORËVE MË LËNDË

Në këtë pjesë do të trajtohet mesatarja e lëndëve në punë në raport me prokurorët që kanë qenë të angazhuar gjatë vitit 2025 në kuadër të ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH-ve. Bazuar në të dhënat zyrtare, numri i përgjithshëm i prokurorëve ka qenë 187, apo 13 më pak sesa në vitin 2024. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka pasur të angazhuar 7 prokurorë, 12 prokurorë të Apelit, 23 prokurorë special dhe 145 prokurorë që shërbejnë në kuadër të shtatë prokurorive themelore (Prishtinë 49, Pejë 16, Gjakovë 10, Mitrovicë 20, Gjilan 15, Ferizaj 17 dhe Prizren 18). Duke qenë se Kryeprokurorët dhe katër anëtarët prokurorët që shërbejnë në KPK nuk ngarkohen më lëndë, atëherë numri i përgjithshëm i prokurorëve që kanë trajtuar lëndë gjatë vitit të kaluar i bie të jetë 174 prokurorë

Nëse e marrim numrin e lëndëve që ka pasur në punë Prokurori i Shtetit në raport me numrin e përgjithshëm të prokurorëve, rezulton se 174 prokurorë kanë pasur në punë 120,535 kallëzime penale, kjo do të thotë se mesatarisht një prokuror ka qenë i ngarkuar me rreth 700 lëndë, apo rreth 50 lëndë më pak sesa në vitin 2024.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, rezulton se prokurorët e Apelit kanë pasur mesataren me të lartë të numrit të rasteve në raport me lëndët në punë, të pasuar nga prokurorët e themeloreve dhe ata që shërbejnë në ZKPSH. Në këtë indikatorë, prokurorët special rezultojnë të jenë më pak të ngarkuar sa i përket sasisë së kallëzimeve penale me vetëm 100 lëndë për një prokuror, një mesatare e ngjashme sikurse edhe në vitin e kaluar.

Tabela 2. Mesatarja e lëndëve që kanë pasur në punë prokurorët brenda një viti, periudha kohore2013 – 2025

Viti	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit	Prokuroria Speciale	Prokuroria e Apelit	Prokuroritë Themelore
2025	260	100	938	771
2024	130	103	865	874
2023	158	133	1182	868
2022	160	128	1115	821
2021	154	129	1012	810
2020	136	128	1471	753
2019	151	146	1160	920
2018	142	116	1148	1047
2017	203	46	724	404
2016	234	72	880	506
2015	412	53	645	540
2014	155	50	549	463
2013	217	48	584	509

BUXHETI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS PËR VITIN 2025

Duke parë ngarkesën e prokurorëve me lëndë, mungesën e stafit profesional në administratë, nevojën për investime në infrastrukturën e sistemit prokurorial, buxheti përben një element kyç për adresimin e këtyre sfidave. Prandaj, në këtë kapitull analizohet ndarja buxhetore për Këshillin Prokurorial të Kosovës si organ që menaxhon me sistemin prokurorial në vend.

Siç shihet nga tabela, bazuar në Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2025[26], KPK merr pjesë me vetëm 0.53% në buxhetin e përgjithshëm të shtetit. Pra nga 3.6 miliard euro sa ka qenë buxheti i vendit, për KPK-në janë ndarë vetëm rreth 19 milion euro. Nëse e bëjmë një krahasim me vitet paraprake rezulton se buxheti i KPK-së është më i larti që nga viti 2013 si vlerë por jo edhe si përqindje në raport më buxhetin e përgjithshëm. Por, kjo nuk pasqyron domosdo një politikë të synuar për forcimin e sistemit prokurorial apo të bazuar në analiza të mirëfillta të nevojave të prokurorisë, pasi që jo të gjitha kërkesat buxhetore që KPK-ja i ka paraqitur janë miratuar nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit.[27]

Edhe në vitin 2025, pjesa më e madhe e buxhetit (13 nga 19 milion euro) kanë qenë të dedikuara për paga edhe meditje të prokurorëve dhe stafit tjetër që shërben në kuadër të KPK-së, rreth 3.5 milion kanë qenë të dedikuara për mallra dhe shërbime, dhe kjo nënkupton që fondet e dedikuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe stafit mbështetës, si dhe për investime tjera kapitale dhe teknologjike mbeten relativisht të ulëta.

Tabela 3. Buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës (2013 – 2025)

Viti	Buxheti i KPK-së	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2025	18,913,922.00 €	3,595,508,786.00 €	0.53
2024	17,265,867.00 €	3,302,323,022.00 €	0.52
2023	15,913,983.00 €	3,211,603,100.00 €	0.50
2022	17,144,178.00 €	2,735,749,600.00 €	0.63
2021	14,441,528.00 €	2,454,209,105.00 €	0.59
2020	15,021,836.00 €	2,356,860,915.00 €	0.64
2019	14,170,065.00 €	2,378,231,797.00 €	0.59
2018	11,092,826.00 €	2,080,480,837.00 €	0.53
2017	9,483,682.00 €	2,001,020,484.00 €	0.47
2016	8,013,619.00 €	1,678,709,487.00 €	0.48
2015	7,158,086.00 €	1,682,486,849.00 €	0.43
2014	6,872,000.00 €	1,589,324,952.00 €	0.43
2013	5,775,534.00 €	1,591,118,599.00 €	0.36

26 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për ndarjet buxhetore për vitin 2025, link: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=99639

27 Raporti i Punës për vitin 2025 i Këshillit Prokurorial të Kosovës, fq.33, link: https://prokuroria-rks.org/uploads/2026/05/3a614087-feab-4925-b98e-1ab0c9ee49f4_Raporti%20Vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%20p%C3%ABr%20Vitin%202025%20-%20Nr.813.2026-KPK.pdf

PERFORMANCA E GJYKATAVE

EFIKASITETI I GJYKATAVE NË ZGJIDHJEN E LËNDËVE

Struktura e gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës përbëhet nga Gjykata Supreme (GJS), Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme(DhPGJS), Gjykata e Apelit (GJA), Gjykata Komerciale (GJK) dhe shtatë gjykatat themelore (GJTH Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë). Nga muaji maj 2026, në këtë strukturë është shtuar edhe Gjykata Administrative, por efikasiteti i kësaj gjykate nuk do të analizohet meqë në këtë kapitull do të flasim vetëm për efikasitetin e gjykatave për vitin paraprak.

Bazuar në raportin statistikor të punës së gjykatave për vitin 2025 rezulton se në punë ishin 410,310 lëndë gjyqësore, 260,698 prej tyre të trashëguara nga vitet e kaluara kurse 149,612 lëndë të reja të pranuara gjatë periudhës raportuese.[28]

Tabela 4. Numri i përgjithshëm i lëndëve në gjykata për vitin 2025

Gjykata	Lëndë në punë gjatë periudhës raportuese	Numri i përgjithshëm i lëndëve gjatë vitit 2025			
		Lëndë të trashëguara	Lëndë të pranuara	Lëndë të zgjidhura	Lëndë të pazgjidhura
Gjykata Supreme	2753	383	2370	2209	544
Dhoma Posaçme	12168	11006	1162	2914	9254
Gjykatat e Apelit	62012	25519	36493	27269	34743
Gjykata Komerciale	16103	9423	6680	5445	10658
Gjykata Themelore	317274	214367	102907	124043	193231
Gjithsej	410310	260698	149612	161880	248430

Duke qenë se efikasiteti i gjykatave llogaritet duke marrë për bazë numrin e lëndëve të reja të pranuara në raport me numrin e lëndëve të zgjidhura për atë vit kalendarik, rezulton se gjykatat kanë treguar efikasitet në shkallë prej 108%. Pra, nga 149,612 lëndë të reja të pranuara gjykatat kanë zgjidhur 161,880 raste gjyqësore. Ndërsa, nëse krahasojmë numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me ngarkesën prej 410,310 lëndë, gjykatat kanë zgjidhur vetëm 40% të lëndëve që kanë qenë aktive në vitin 2025.

Me këtë shkallë efikasiteti, gjykatave i duhet së paku 1 vit e gjysmë për zgjidhur të gjitha lëndët në punë, me kusht që nuk pranojnë lëndë të reja.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë shihet se përveç Gjykatës Komerciale e cila ka rënë nga një shkallë efikasiteti prej 97% në vitin 2024 në 82% në vitin 2025, të gjitha nivelet e tjera të gjykatave kanë rritur efikasitetin ose kanë ruajtur shkallën e efikasitetit në raport me vitin e kaluar. Kësisoj, shkalla prej 121% efikasitet e gjykatave themelore është më e larta që nga viti 2019, kurse efikasiteti i Dhomës së Posaçme prej 224%, paraqet shkallën e dytë më të lartë të efikasitetit të saj që nga viti 2013.

28 Raporti statistikor i punës së gjykatave për vitin 2025, link: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/99300_KGJK_Raporti_Statistikor_Gjykatave_Vjetori_2025.pdf

Tabela 5. Përqindja e efikasitetit të gjykatave në zgjidhjen e lëndëve në raport me lëndët e pranuara për periudhën 2013 - 2025

Viti	Gjykata Supreme	Dhoma e Posaçme	Gjykata e Apelit	Gjykatat Themelore	Gjykata Komerciale
2025	93	251	75	121	82
2024	93	224	71	98	97
2023	99	162	90	92	96
2022	114	165	91	76	50
2021	99	203	79	66	
2020	84	264	106	60	
2019	95	135	108	177	
2018	110	92	97	161	
2017	98	112	90	145	
2016	89	130	186	110	
2015	105	46	89	98	
2014	98	28	92	109	
2013	201	54	103	80	

NGARKESA E GJYQTARËVE MË LËNDË GJATË VITIT 2025

Në këtë pjesë të Indeksit analizohet ngarkesa e gjyqtarëve që kanë qenë të angazhuar në zgjidhjen e lëndëve në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve gjyqësore që kanë qenë në punë gjatë vitit 2025.

Raporti statistikor i punës së gjykatave thekson se në gjykatat e Kosovës gjatë vitit 2025 kanë qenë të angazhuar 434 gjyqtarë në total, ku 373 nga ta kanë qenë të angazhuar në zgjidhjen e lëndëve (13 në Gjykatën Supreme, 14 në Dhomën e Posaçme, 55 në Gjykatën e Apelit, 18 në Gjykatën Komerciale dhe 273 në gjykatat themelore).

Duke llogaritur numrin e përgjithshëm të lëndëve aktive gjatë vitit 2025 në raport me gjyqtarët e angazhuar, rezulton se një gjyqtar ka qenë i ngarkuar me 1100 lëndë. Gjyqtarët e gjykatave themelore kanë pasur ngarkesën më të madhe me lëndë, pra 1162 për një gjyqtar, të pasuar nga ata të Apelit me 1128 lëndë dhe të gjykatës komerciale me 895 lëndë. Të dhënat në tabelë tregojnë që në vitin 2025, Gjykata Supreme dhe ajo e Apelit kanë shënuar rekord me numrin e lëndëve në punë për një gjyqtar, mesatare kjo më e larta që nga viti 2013. Kurse, mesatarja e lëndëve për gjyqtarët e Gjykatave Themelore dhe Dhomës së Posaçme ka shënuar një rënie nga viti paraprak për rreth 200 lëndë më pak, kurse Gjykata Komerciale vazhdon trendin e njëjtë të të mesatares së ngarkesës së gjyqtarëve me lëndë.

Tabela 6. Mesatarja e ngarkesës së gjyqtarëve me lëndë gjatë viteve 2013-2025

Viti	Gjykata Supreme	Dhoma e Posaçme	Gjykata e Apelit	Gjykatat Themelore	Gjykata Komerciale
2025	212	869	1128	1162	895
2024	198	1058	845	1366	883
2023	147	1178	798	1379	910
2022	114	1246	642	1091	1005
2021	132	1267	649	896	
2020	99	1477	497	595	
2019	89	2070	552	899	
2018	86	1519	649	1330	
2017	106	1837	680	2224	
2016	88	1850	644	3187	
2015	83	1816	539	2848	
2014	75	2211	583	3080	
2013	121	821	558	3133	

BUXHETI PËR KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS GJATË VITIT 2025

Buxheti i pamjaftueshëm në raport me kërkesat dhe nevojat e gjyqësorit vazhdon të mbetet sfidë për KGJK-në si organ kolegjiale që menaxhon me të gjitha gjykatat në nivel vendi. [29] Pavarësisht që buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës në vitin 2025 arriti shifra rekorde prej 3.6 miliardë eurosh, vetëm 1% e kësaj vlere u destinua për KGJK-në. Nëse e krahasojmë pjesëmarrjen në përqindje të gjyqësorit në buxhetin e përgjithshëm të shtetit rezulton se për këtë institucion është buxheti më i vogël i ndarë që nga viti 2013.

Një situatë e tillë e krijuar në gjyqësor dhe mos trajtimi i duhur i kërkesave buxhetore nga ana e Qeverisë dhe Kuvendit ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e gjykatave dhe në aftësinë e tyre për t'i trajtuar lëndët brenda një afati të arsyeshëm, duke ndikuar kështu edhe në qasjen e qytetarëve në drejtësi dhe në cilësinë e shërbimeve gjyqësore.

Për më tepër, duhet marrë parasysh që rreth 90% e këtij buxheti ka qenë i planifikuar për shpenzime të detyrueshme si paga, mëditje, mallra e shërbime. Kjo situatë mund të kufizojë KGJK-në për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës, por edhe për projekte zhvillimore që mund të përmirësonin funksionimin më efikas dhe më afatgjatë të sistemit gjyqësor.

29 Këshilli Gjyqësor i Kosovë, Deklarimi i ish-kryesuesit Albert Zogaj, dhjetor 2025, link: https://www.facebook.com/keshilligjyqesorikosoves/posts/n%C3%AB-fjalimin-e-tij-kryesuesi-i-kgjk-s%C3%AB-albert-zogaj-theksoi-se-mosrealizimi-i-k%C3%ABr/1458540256280600/

Tabela 7. Buxheti i KGJK për periudhën 2013 – 2025

Viti	Buxheti i KGJK-së	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2025	36,062,871.00 €	3,595,508,786.00 €	1.00
2024	35,806,910.00 €	3,302,323,022.00 €	1.08
2023	34,155,572.00 €	3,211,603,100.00 €	1.06
2022	32,183,896.00 €	2,735,749,600.00 €	1.18
2021	29,194,592.00 €	2,454,209,105.00 €	1.19
2020	29,821,540.00 €	2,356,860,915.00 €	1.27
2019	29,404,466.00 €	2,378,231,797.00 €	1.24
2018	23,495,024.00 €	2,080,480,837.00 €	1.13
2017	21,793,948.00 €	2,001,020,484.00 €	1.09
2016	20,465,770.00 €	1,678,709,487.00 €	1.22
2015	21,288,771.00 €	1,682,486,849.00 €	1.27
2014	20,833,483.00 €	1,589,324,952.00 €	1.31
2013	19,910,467.00 €	1,591,118,599.00 €	1.25

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

Ky edicion i dhjetë i RoLPIK vë në pah faktin se perceptimi i qytetarëve në raport me pavarësinë e sistemit të drejtësisë vazhdon të mos jetë i kënaqshëm, pavarësisht që shkalla e efikasitetit institucional ka shënuar trend pozitiv. Ndikimi politik dhe dukuria e ryshfetit tek zyrtarët e gjykatave dhe të prokurorive vazhdojnë të shihen si elementet kryesore që cenojnë paanshmërinë në vendimmarrje, e cila reflektohet edhe në vlerësimin e qytetarëve ku rreth gjysma e të anketuarve nuk kanë shohin përmirësim të gjyqësorit gjatë 5 viteve të fundit.

Pavarësisht zhvillimeve politike dhe tendencave të herëpashershme për destabilizim të sigurisë në vend, në perceptimin qytetar niveli i sigurisë mbetet në shkallë të lartë. Ky perceptim reflekton edhe vlerësimin se Policia e Kosovës është institucioni më efektiv për luftimin e kriminalitetit dhe gatishmërinë e rreth 70% të të anketuarve për të raportuar raste tek ky institucion.

Në raport me reformat në drejtësi, qytetarët i japin përparësi fuqizimit të institucioneve aktuale në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe jo krijimit të institucioneve të reja. Sipas tyre, pengesat kryesore për mos realizimin e reformave kryesore mbesin arsyet politike përkatësisht mungesa e vullnetit dhe konsensusit politik.

Përformanca në disa nga gjykatat dhe prokuroritë ka shënuar trend pozitiv por numri i madh i lëndëve aktive dhe ngarkesa e gjyqtarëve dhe prokurorëve mbesin sfida që determinojnë faktin se shumë lëndë rrezikojnë parashkrimin ose mohimin e të drejtës së qytetarëve për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Përveç këtyre, si sfidë mbetet edhe buxheti i kufizuar që i është dedikuar KGJK-së dhe KPK-së përgjatë viteve, i cili ka reflektuar në numër të pamjaftueshëm të stafit profesional dhe administrativ dhe në performancën e përgjithshme të vetë sistemit të drejtësisë.

Rekomandime

Nga të dhënat që përmban Edicioni i Dhjetë i RoLPIK, ofrohen rekomandimet e mëposhtme:

- Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës

1. KGJK dhe KPK të zbatojnë politikat aktuale për rritjen e profesionalizmit, pavarësisë, transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit publik, dhe të vlerësojnë nevojën e politikave të reja që i kontribuojnë ushtrimit efikas të autoritetit të tyre dhe perceptimit publik në raport me dukurinë e mitmarrjes nga zyrtarët e gjykatave dhe prokurorive;
2. KGJK dhe KPK të promovojnë në publik punën e gjykatave dhe prokurorive, duke aplikuar edhe konferencat për media sidomos për rastet dhe çështjet që kanë ndikim më të madh në publik;
3. KGJK rekomandohet të avancojë edhe më tutje shërbimet gjyqësore online dhe që të gjej mënyra për promovimin e këtyre shërbimeve për qytetarët;
4. Gjykatat dhe prokuroritë të vazhdojnë të rrisin shkallën e efikasitetit të zgjidhjes së lëndëve, dhe të dëshmojnë trajtim profesional, të barabartë dhe të drejtë të secilit rast, pavarësisht statusit të palëve në procedurë;
5. Të vazhdohet praktika e mirë e gjykatave dhe prokurorive për takimet e hapura me qytetarët, duke respektuar njëkohësisht pavarësinë e gjyqësorit dhe konfidencialitetin e procedurave.

- Për Kuvendin e Republikës së Kosovës

1. Kryesia e Kuvendit dhe deputetët të distancohen nga përdorimi i gjuhës që ka për qëllim ndërhyrjen në pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe që cenon parimin e ndarjes së pushteteve;

2. Deputetët e Kuvendit të Kosovës të arrijnë konsensus për procedimin tutje të amendamenteve kushtetuese dhe projektligjeve të tjera që hyjnë në kuadër të reformave në drejtësi;

3. Kuvendi i Republikës së Kosovës t'i trajtojë me seriozitet raportimet vjetore me shkrim që dorëzohen nga KGJK dhe KPK, dhe me rastin e miratimit të Ligjit për Ndarjet Buxhetore të sigurohet që buxheti i ndarë të jetë konform kërkesave të tyre;

- Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

1. Kabineti Qeveritar të distancohet nga përdorimi i gjuhës që ka për qëllim ndërhyrjen në pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe që cenon parimin e ndarjes së pushteteve;

2. Ministria e Drejtësisë të trajtojë me kujdesin e duhur nismat për reformat në drejtësi, duke bashkëpunuar dhe i bashkërenduar këto aktivitete me sistemin e drejtësisë, shoqërinë civile dhe akterët e tjerë;

3. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet t'i trajtojë me prioritet të lartë kërkesat buxhetore që parashtrohen nga ana e KGJK-së dhe KPK-së, me qëllim që t'i mundësohet gjyqësorit që të kryej në mënyrë të pavarur dhe efikase të gjitha autorizimet dhe kompetencat që i njihen me Kushtetutë dhe ligjet në fuqi

Rreth RoLPIK

RoLPIK ka për qëllim kryesor të promovojë përmirësimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve në kërkimin e përgjegjësisë mbi performancën e sistemit te drejtësisë, përmes monitorimit, konsultimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm.

Për më shumë rreth platformës RoLPIK vizitoni:

www.rolpik.org

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, apo Suedisë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Suedia
Sverige

KCSF
FONDACIONI KOSOVAR PER SHOQERI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Suedia
Sverige

KCSF
FONDACIONI KOSOVAR PER SHOQERI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION